

“Action on Pre-eclampsia” është një shoqatë bamirësie bazuar në Mbretërinë e Bashkuar, e krijuar në vitin 1991. Ne ndihmojmë dhe mbështetim gra që kanë vuajtur nga pre-eklampsia, eklampsia, sindromi HELLP ose hipertensioni i shkaktuar nga shtatzania (PIH).

“Action on Pre-eclampsia” u krijua për të mbështetur dhe informuar gra që kishin vuajtur nga pre-eklampsia. Që nga ajo kohë, edhe pse jemi rritur si organizatë, vizioni ynë dhe synimet kanë mbetur po ato.

Vizioni ynë është për një të ardhme ku pre-eklampsia të mos përbëjë më kërcënim serioz për shëndetin dhe mirëqenien e nënave dhe fëmijëve të tyre të palindur. Misioni ynë është të parandalojmë ose të paktën të lehtësojmë vuajtjet e shkaktuara nga pre-eklampsia, nëpërmjet nxitjes së vetëdijës publike, thellimit të njohjes dhe aftësive profesionale dhe mbështetjes së menjëhershme dhe të vijueshme të familjeve të prekura.

Qëllimi ynë është të edukojmë, informojmë dhe këshillojmë publikun dhe personelin shëndetësor për përhapjen, natyrën dhe rreziqet e pre-eklampsisë. Luftojmë për të nxitur një vetëdije publike më të fortë në lidhje me këtë sëmundje dhe për të marrë masa që të përmirësohen metodat e diagnostikimit dhe të trajtimit të saj. Ofrojmë mbështetje për gratë që vuajnë nga kjo sëmundje dhe familjet e tyre, dhe nxitim studimin shkencor të shkaqeve të sëmundjes si dhe të teknikave të përshtatshme diagnostikuese dhe metodave të mjekimit.

Ne u japim informacion për pre-eklampsinë grave shtatzana, familjeve të prekura dhe personelit shëndetësor që kujdeset për nënën dhe fëmijën. Gjithashtu ofrojmë edukim profesional për pre-eklampsinë, nëpërmjet një programi të vijueshëm konferencash dhe ditësh studimore. Kemi një linjë telefonike ndihme (+208 427 4217), një rrjet dashamirësh lokalë dhe ofrojmë mundësi për t’u këshilluar dhe mjekuar nga ekspertë të fushës.